

VENDIM
Nr. 13, datë 9.6.2014

PËR RINOVIM LICENCE SHA UJËSJELLËS KANALIZIME LIBRAZHD

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence, për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor, operatorit sh.a. Ujësjellës-Kanalizime Librazhd, me:
 - drejtues ligjor: Agron Gega;
 - drejtues teknik: Ermela Xherri.
2. Operatori sh.a. UK Librazhd autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:
 - Kategoria A, për grumbullimin dhe shpërndarjen e ujit për konsum publik.
 - Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.
3. Zona e shërbimit të këtij operatori është:
 - bashkia: Librazhd, Përrenjas;
 - komuna: Qendër, Rrajcë.
4. Kjo licencë është e vlefshme deri më datë 18.1.2016, siç është përcaktuar në vendimin e KKRR nr. 1, datë 18.1.2012.

KRYETARI
Avni Dervishi